



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 49/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së fotografisë së kandidatit për kryetar komune para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore për zgjedhjet jashtëzakonshme lokale për kryetar komune në Ferizaj, në seancën e panelit të mbajtur me 20.04.2012, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë ankesa si e palejuar.

### Arsyetim

PZAP-i, me datë 19.04.2012, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK dega në Ferizaj, me të cilin thekson se LVV ka bërë shkeljen e Rregullave ligjore të fushatës zgjedhore, e cila zyrtarisht fillon me datën 23.04.2012, poashtu parashtruesi i ankesës pretendon se janë bërë shkelje të dispozitave ligjore të LZP-së, dhe Kodin e mirësjelljes për subjektet politike, duke e vendosur fotografimin e kandidatit për kryetar komune nga kjo lëvizje Faton Topallit në hapësirat publike.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotot e kandidatit të LVV për kryetar komune.

Neni 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Rregulla Zgjedhore nr. 11/2009, Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2009 Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, siç del nga të gjitha dispozitat ligjore dhe Rregullat Zgjedhore të lartcekura, ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësit e tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

**ankesa është e palejuar**

Me që dispozitat e parapara ligjore të LZP-së dhe Rregullat Zgjedhore, përcaktojnë të drejtat e subjekteve politike si dhe veprimet e ndaluara të tyre vetëm gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, dhe meqenëse veprimet e pretenduara janë zhvilluar para datës zyrtare të përcaktuar për fillimin e fushatës zgjedhore, si dhe duke u bazuar në atë se me asnjë dispozitë të paraparë të LZP-së dhe as me Rregullat Zgjedhore nuk është paraparë sanksionimi apo marrja e masave tjera ndëshkimore ligjore për vendosjen e pankartave dhe posterave publike apo mbajtjen e fushatës zgjedhore para datës së përcaktuar për mbajtjen e saj.

Në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 49/2012 më datën 20.04.2012.

